

A K T - THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"KOKA" SH.P.K.

Në mbështetje të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë tregtare" unë shtetësi Rëkîp Koka i biri i Mehmetit dhe i Ismes i datëlindjes 19.04.1974 lindur në Martanesh-Bulgazë dhe banues në Qytetin Krastë, sot me datën 15/5/1998 me vullnetin tim të lirë dhe të plotë vendosa të themeloj shoqërinë tregtare private me përgjegjësi të kufizuar "KOKA" SH.P.K. me qëndër në Krastë me këto kushte:

Neni 1.

Në krijimin e aktit të themelimit ortaku i vetëm Rëkîp Koka është themeluesi i shoqërisë tregtare private me përgjegjësi të kufizuar "KOKA" SH.P.K.

Neni 2


Të drejtat dhe detyrat e ortekut të vetëm themelues janë përcaktuar hollësisht në statutin e shoqërisë.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "KOKA" SH.P.K. do të jetë: Shfrytëzimi dhe tregtimi i mineraleve të ndryshme (krom etj.) brenda dhe jashtë vendit import_eksport i tyre, tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, blegto-rale, pyjore, të ndërtimit, bimve medicinale, eksport-import i tyre.

Neni 4

Akt-themelimi do të jetë efektiv nga data e regjistrimit të shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Nga kje datë shoqëria fiton zotësinë për të vepruar si person juridik i pavarur.



Neni 5

Ortaku i vetëm themelues është i detyruar të zbatojë statutin e shoqërisë. Asambleja e ortakve dhe administratori i shoqërisë mund të marrë masa ndërrshkimore ndaj personave të punësuar në shoqëri në përputhje me statutin e shoqërisë.

Neni-6

Ortaku themelues dhe gjithë punëjësit e shoqërisë janë të detyruar të ruajnë karakterin e fshehtë të dokumentacionit, informacionit, njohurive të përvojës së shkëmbyer në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë. Të ruaj fshtësinë dhe identitetin e shumave dhe të ardhurave të shoqërisë, depozitave të sajë dhe veprimtarinë e shoqërisë ta pasqyrojë në bilancin vjetor.

Neni 7


Kapitali fillestarë i themelimit të shoqërisë është 100.000lekë dhe përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm. Kapitali i themelimit të shoqërisë dhe kapitali i nevojshëm mund të krijojnë një fond të veçantë që do të mbahet në llogarinë e shoqërisë në bankë.

: Neni 8

Fondet monetare të shoqërisë do të përdoren nga asambleja e ortakve dhe administratori i saj në përputhje me detyrat e përcaktuara në statutin e shoqërisë në lidhje me objektin e veprimtarisë dhe shtrirjen e saj.

Neni 9

Shoqëria "KOKA" SH.P.K. duke qënë person juridik i pavarur rregullon veprimtarinë e sajë në përputhje me dispozitat e këtij Akt-themelimi të statutit të shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



Neni 10

Të gjitha mosmarrveshjet në shoqëri zgjidhen nga asambleja e kësaj kështre dhe kur është e mundur nga gjykatat.



Neni 11

Shoqëria tregtare "KOKA" SH.P.K. e ka qendrën e saj në Qytetin e Krastës. Ajo mund ta zhvillojë veprimtarinë e sajë në gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë sajë.

QRTAKU I VHTËM THEMELIUES

(Rakip Koka)

Rakip Koka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 3883 Rep.
Nr. 1085 Kol.


V E R T E T I M

Sot me datën 14/5/1998 në zyrën e noterisë Tiranë, para meje Noteres u paraqet personalisht Z. Rakip Koka me gjeneralitetet e mësipërme madhëse, me sotësi të plotë juridike për të vepruar për indentifikimin e të cilit u bazova në letër-njeftimin personal NE 124/98 i cili deklaroi se sa sipër është Aktë-themelimi SH.P.K. "KOKA" i hartuar jashtë kësaj zyre me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe sipas rregullave e firmos para meje ndërsa unë e vërtetoj dhe e regjistroj sipas ligjit.



NOTERE
MIMOZA SHEHU
NR. TEL: _____ ZYRE
TEL: 271-2-111 199

Mimoza Shehu



S T A T U T I

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"K O K A" Sh. P.K.



Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KOKA" Sh.p.k. me ortak të vetëm Z. R. Koka i biri i Mehmetit, i datëlindjeq 19.04.1974 lindur në Peshatin Gjen - Martanesh, Bulqizëdhe banues në Qytetin e Krastës, në mbështetje të ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1993 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr. 7667 datë 28.01.1993 "Për reg jistrim tregtar" harton STATUTIN e shoqërisë si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRG JITHSHME

Neni 1

Shoqëria tregtare private "KOKA" sh.p.k.në këtë statut rregullon pozitën juridike të ortakut të vetëm dhe të punonjësave të shoqërisë të dhënat për qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.

Neni 2

Shoqëria është krijuar me aktin e themelimit të ortakut të vetëm me mjetet vtjake të tijë. Shoqëria ka statutin e personit juridik me regjistrimin në gjykatë.

Neni 3

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm është emërtuar "KOKA" SH.P.K. Shoqëria ka villën e sajë.

Neni 4

Selia e shoqërisë është në KRASTË. Veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë teritorin e SHqipërisë si dhe jasht vendit

Raf

Neni 5

Shoqëria ka një kohë zgjatje prej 10-vjetësh.

II. OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KOKA" do të jetë:

Tregtimi i mineraleve të ndryshme (krom etj) brenda dhe jashtë vendit, eksport-import. Tregtimi me shumicë e pakicë i produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, blektorale, pyjore, të ndërtimit bimave medicinale, eksport import i tyre.

III. MJETET E SHOQËRISË

Neni 7


Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë. Ky përbën burimin fillestar për krijimin e fondit themeltar e të mjeteve të xhiros.

Neni 8

Shoqëria disponon lirisht pronën dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë të përdorë ato në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së sajë.

Neni 9

SH.P.K. do të çelë në llogarinë rrjedhëse në bankën ku do të depositejë kapitalet e sajë financiare. Ajo do të mbajë llogarinë duke u mbështetur në lekun Shqiptarë dhe në monedhat e huajetë fuqishme.



Neni 10

SH.P.K. do të ketë si vit fiskal vitin kalendarik. Bilanci i shoqërisë mbyllet më 31-Janar të çdo viti.

Neni 11

Fitimet e realizuara nga shoqëria pas shlyerjes së detyrimeve, zbritjes së shpenzimeve të tjera i nënshtrohen taksës në masën që i cakton organi kompetent.

Neni 12

Shoqëria cakton fondet e mëposhtme:

- Fondi themeltar. Ky fond shfrytëzohet për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë, për investime si dhe për të mbuluar rreziqet pas shfrytëzimit të mjeteve të rezervës. Fondin themeltar shoqëria mund ta shfrytëzojë edhe për destinacione të tjera në përputhje me qëllimet e saj afariste.

- Fondi rezervë. Ky fond shfrytëzohet për të mbuluar humbjet dhe rreziqet si dhe për destinacione të tjera në përputhje me qëllimet e saj afariste. Fondi rezerve i shoqërisë formohet nga ajo pjesë e fitimit që ajo realizon gjatë veprimtarisë së sajë.

Për ushtrimin e veprimtarisë së sajë shoqëria mund të përcaktojë edhe fonde të tjera. Sa sia në përqindje për sejoilin fonde të përcaktohet pas 6-mujsh aktivitet të shoqërisë.

IV. ORGANET DREJTUESË DHE ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Neni 13

Organi më i lartë i shoqërisë është asambleja e ortakve (ortaku i vetëm) i cili ushtron këto funksione:

Nxjerrë programin e zhvillimit dhe aktivitetet e përgjithshme vendimin për ndryshimin e emërtimit të selisë dhe të veprimtarisë së shoqërisë, vendos për krijjen ose paktimin e kapitalit themeltarë të shoqërisë, miraten bilancin e shoqërisë dhe raportin financiar vjetor të sh.p.k. vendos për ndryshimin e formës së organizimit të sajë, vendos për ndarjen dhe përdorimin e fitimit si dhe për mbulimin e humbjeve dhe të rreziqeve, vendos për mbylljen e veprim

Raf

tarisë së shoqërisë, emron dhe shkarkon administratorin e shoqërisë nën shtimin e ortakve paranimi i të cilve bëhet sipas ligjeve në fuqi.

Administratori i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KOKA" sh.p.k. është z.Mehmet Koka. Ai do të jetë përfaqësuesi juridik në të gjitha marrëdhëniet e veprimtarisë së sajë me shtetin, shteteve të huaja dhe personave të tretë.

Neni 14

Administratori i shoqërisë lidh marrëdhënie, kontakte, kryen veprime financiare, organizon dhe drejton aktivitetin dhe të gjitha marrëdhëniet në bazë të statutit, përcakton rregullat dhe kriteret e mbajtjes së dokumentacionit të shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi, përgjigjet për ligjëshmërinë dhe aktivitetin ekonomik të shoqërisë, organizon marrjen në punë të punonjësve si dhe kualifikimin e tyre, emron dhe shkarkon shefat e sektorve të shoqërisë. Në mungesë apo në pamundësi të ushtrimit të funksionit të administratorit atë e zëvendëson me një nga punonjësit që e cakton ai vetë.

Neni 15

Janë sekrete të punës vendimet e nxjerrura nga shoqëria shkre-
set e ndryshme si dhe materialet e tjera që kanë të bëjnë me të dhëna të rëndësishme si ato financiare etj. Sekretin e punës janë të detyruar ta ruajnë të gjithë antarët e shoqërisë. Të dhënat që paraqisin sekret të punës mund tu bëhen të njohura personave të tjerë vetëm me lejen e administratorit të shoqërisë. Detyra e ruajtjes së sekretit të punës vazhdon edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me shoqë-
rinë.

Neni 16

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen në përputhje me aktin e themelimit në këtë statut dhe legjislacionin në fuqi. Për personat që do të punësohen në këtë shoqëri do të lidhin kontra-
tat sipas ligjit.



V. MBYLLJA E SHOQËRISË

Neni 17

Shoqëria mbyllë veprimtarinë e sajë në rastet e parashikuara në legjislacionin Shqiptarë. Me vendim të ortakve të vetëm kur hapet procedura e likuidimit. Shoqëria mund të shpërndalet në formën e riorganizimit të likuidimit. Shpërndaletja e shoqërisë në formën e likuidimit mund të bëhet kur shoqëria nuk është më efektive. Në këtë rastë nga ana e administratorit të shoqërisë caktohet komisioni i likuidimit dhe kompetencat e tijë.

Neni 18

Shoqëria shpërndalet pasi jepen konklusionet nga komisioni i likuidimit dhe shlyen detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Nëse do të shihet e nevojshme do të bëhet shtim ortaku duke shtuar rregullat e caktuara.

Neni 20

Ndryshimi dhe plotësimi i këtijë statutibëhet në njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilin nxirret ky statut.

Neni 21

Statuti hyn në fuqi ditën e miratimit nga ortaku i shoqërisë.

Neni 22

Mosmarrveshjet që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë me të tretët e tjerë do të bëhen përpjekje për tu zgjidhur me mirkuptim dhe kur ajo nuk jep rezultatet e duhura, zgjidhja do të bëhet në Gjykatën e Rrethit Bulqizë.